



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.89/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj, kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 23.01.2025, merr këtë:

VE N D I M

- I. PRANOHET e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.89/2025 e datës 21.01.2025
- II. Partia Demokratike e Kosovës, (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 4,500.00 (katërmijepesëqind) euro.
- III. Detyrohet Partia Demokratike e Kosovës (PDK), që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datën 21.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se shefi i kabinetit të Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë, Bujar Shatrolli, ka postuar një fotografi në llogarinë e tij në facebook, se bashku me Besim Demiraj, drejtor për Inspektime dhe Albanëz Tahiraj, drejtor i Arsimit në Komunën e Vushtrrisë, të realizuar në hapësirën e brendshme të Komunës së Vushtrrisë, në kundërshtim me dispozitat ligjore zgjedhore duke shfrytëzuar kështu dhe institucionet publike shtetërore për qëllime elektorale për përfitime të votave për subjektin e tyre politik PDK, dhe duke bërë thirrje që të votohet subjekti politik PDK me numër 131 dhe kandidati për kryeministër Bedri Hamza. Më tutje parashtruesi i ankesës thekson se me këtë veprim, janë shkelur dispozitat ligjore të nenit 36, paragrafët 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotografinë dhe linkun ku

dëshmohej veprimi në kundërshtim me LZP-në <https://www.facebook.com/photo/?fbid=9478310178892012&set-a.405326182857169>.

Më datë 22.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Partia Demokratike e Kosovës, (PDK), për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me datë 22.01.2025 në ora 17:00.

Në përgjigjen në ankesë të datës 22.01.2025, subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, (PDK), thekson se në momentin e vënies në dijeni për këtë rrethanë, në bazë të nenit 33, par. 6 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme, me qëllim të evitimit të shkeljeve të pretenduara me këtë ankesë, ashtu që Shefi i kabinetit të Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë, menjëherë pas pranimit të njoftimit nga PDK, ka ndërmarrë masat përmirësuese, duke i fshirë të gjitha postimin e bërë në rrjetin social Facebook, dhe lidhur më këtë ka bashkangjitur përgjigjes si provë ku shihet duke u fshirë të njëjtin postim.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga prova materiale e bashkangjitur ankesës, së subjektit politik LVV, dhe shkresave tjera të lëndës, paneli ka vlerësuar se nga ana e shefit të kabinetit të Komunës së Vushtrrisë Bujar Shatrolli, Besim Demirajt drejtor për Inspektime dhe Alban Tahirajt, drejtor i Arsimit në Komunën e Vushtrrisë është shkelur neni 36 i LZP i cili përcakton: *Personi që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë atë zyrë ose ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike, qoftë të nivelit qendror ose lokal, ose edhe ndonjë ndërmarrjeje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale, nuk mund të shfrytëzohen ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje*, pasi që shefi i kabinetit të Komunës së Vushtrrisë, në fjalë për qëllime elektorale për përfitime të votave për subjektin e tyre politik PDK, dhe duke bërë thirrje që të votohet subjekti politik PDK me numër 131 dhe kandidatit për kryeministër Bedri Hamza.

Kështu që paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se ky veprim i tyre përben shkelje të legjislacionit zgjedhor. Kjo konsiston në atë se subjekti politik PDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore, andaj promovimi i kandidatëve të subjektit të tij politik PDK, duke shfrytëzuar institucionin publik - Komunën e Vushtrrisë, përben shkelje të legjislacionit zgjedhor, saktësisht e sanksionuar me dispozitën e lartcekur të rregullës zgjedhore.

Paneli me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë ka marrë për bazë faktin që subjekti politikë në fjalë ka bërë përpjekje dhe ka fshirë postimin nga rrjeti social Facebook, por se njëkohësisht në lartësinë e dënimit me gjobë është marrë për bazë fakti se subjekti i njëjtë politik ka bërë të njëjtën shkelje dhe për këtë është dënuar me vendimet e Panelit me numër Anr.61/2025, Anr.63/2025 dhe Anr.69/2025.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet në ankesë janë të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi, sepse kjo shkelje ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës, demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi si të bazuar.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 36 paragrafi 1, neni 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nën paragrafi 1.3, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.89/2025 më datën 23.01.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së.